

**ENTIRREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.05.2020

**NJOFTIM****Për mbledhjen Nr. 22, datë 02.06.2020, ora 10:00  
të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 02.06.2020, ora 10:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 22 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

**1-** Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. për rishikimin e vendimit të ERE nr. 73/2020 mbi miratimin e “Kontratë tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU për furnizimin e klientëve fundorë”

**2-** Mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.05.2020, “Për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Voskopojë” me kapacitet të instaluar 1970 kW.”

**3-** Mbi licencimin e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

**4-** Çështje të brendshme të ERE-s

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019” dhe Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE  
Petrit AHMETI**